



**VENDIM**

**Nr. 4 Datë 17.01.2014**

**MBI**

**MODIFIKIMIN E LIÇENSËS ME NR. 17, SERIA PV04P, TË SHOQËRISË  
“MARJAKAJ” SH.P.K, PËR “PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE” NGA  
HEC “BENE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 43, DATË 14.10.2004**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9; 13 pika 1, gërma “a”; 19 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 13; 14 pika 2; 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008; pikave 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike”; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.01.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k për modifikimin e liçensës për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Bene” me Nr. 17, Seria PV04P, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr 43, datë 14.10.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”** : Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. me Nr. 17, Seria PV04P për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec ”Bene” me fuqi 125 KW, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr 43 date 14.10.2004.
2. Fuqia e instaluar e Hec “Bene”, nga 125 KW të bëhet 1000 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.